



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ prot.

Lezhe, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne administrim te Bashkise Lezhe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: **197,428,355** (njqind e nentedhete e shtate milion e katerqind e njetzet e tete mije e treqind e pesedhete e pese) Lek pa TVSH.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesi dhe fillimit te afateve te ankimimit t.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore;
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim .

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore;
4. Akt kolaudimi objekti;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-1 A** Punime gërmimi në tokë.
- NP-4 D** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- NP-12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-18 A** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “*Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licensën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban*

përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane."

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndertimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe jane analizuar ne tabelen e meposhteme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
NP-1 A Punime germimi në tokë.	Ne preventiv parashikohen punime germimi dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet prej 6247 m ³	2,257,790.74 leke
NP-4 D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.	Ne preventiv parashikohen punime per sistemimin dhe asfaltimin e rrugeve Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Transport dheu me auto deri 5.0 km "Shtrese cakulli 20 cm, makadam, përhapur e ngjeshur makineri" Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese stabilizant t=8 cm (bankinat) Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri.	195,102,830 leke

NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore	Ne specifikime teknike parashikohet se “Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që linjat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole në baze të evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund të çojë në ndërprerjen e kontratës”.	0-20,000,000 leke
NS-18 A Punime topogjeodezike.	Referuar relacionit teknik dhe specifikimeve teknike zbatuesi i punimeve është i ngarkuar për kryerjen e punimeve për piktimin e trupit të rrugës dhe nxjerrjen e kuotave.	0-20,000,000 leke

I. Në lidhje me kërkesën për disponueshmëri të kategorisë së pikës NP-12, të licencës dhe nivelit të klasifikimit "A", Njësia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrime të përgjithshme në kujdesin për mjedisin.

N.P. 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore", ***Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor***, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Sa i përket klases "A" së kërkuar, theksojmë se kjo fushë specifike nuk shprehet në zera konkret të preventivit, por është komplekse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, nga momenti i marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit deri në përfundimin e punimeve dhe dorëzimin pranë AK-së, të sheshit të ndërtimit, e për rrjedhojë kjo kërkesë është në proporcion me natyrën, volumin dhe kompleksitetin e kontratës.

II. Në lidhje me kërkesën për disponueshmëri të kategorisë së pikës NS-18, të licencës dhe nivelit të klasifikimit, Njësia ka marrë në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë piktimi do të kryhet nga Sipermarresi.

Theksojmë se kërkesa për këto kategori dhe klase license është bërë dhe në përputhje me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku përcaktohet se:

N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet ***zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.***

Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumin dhe kompleksitetin e kontrates dhe kategorite dhe klasat e licencës janë ne proporcion me raportet teknike, specifikimet teknike objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008

2.3.3 Operatoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 35 (tridhjetë e pese) personave të siguruar për periudhen Shkurt 2024 - Prill 2024.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;

b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit te mesiperem per numerin minimal te punonjesve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatoret Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

- | | |
|-----------------------|----------------|
| a. Inxhinier Ndërtimi | 2 (dy) |
| b. Inxhinier Mjedisi | 1 (nje) |
| c. Inxhinier Gjeodet | 1 (nje) |

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen Shkurt 2024 - Prill 2024.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve. Per me teper duke qene se keto punime jane te nje rendesie te vecante dhe ne te njeften kohe konsistojne ne nderhyrje mjedisore shikohet e nevojshme qe te kerkohen specialist te fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Mjedisori dhe Inxhinier Gjeodet.

Ne lidhje me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier ndertimi, njesia prokurimit ka marre ne konsiderate se projekti per sistemimin dhe asfaltimin e rrugeve rurale ne territorin e Bashkise Lezhe, ka si qellim kryesor qe te siguroje segment rrugore sipas standarteve ne fushen e transportit rrugor.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedisori, Njesia ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te pergjithshme ne kujdesin per mjedisin. Metodat e punës qe duhet te aplikohen nga zbatuesi duhet te synojnë ne minimizimin ose nëse eshte e mundur ne ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet qe te ndermerren me regorozitet masa mbrojtese sa here qe te jete e nevojshme per te minimizuar ose per te ndaluar efektin negativ ne mjedis.

Ne lidhje me me kerkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithë piketimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Sa me siper analiza e ketyre te dhenave dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohet te realizohet, kerkon mimimalisht inxhinieret e kerkuar.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Ing. Ndertimi, Profili Gjeoteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Ing. Gjeodet	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeodet (topograf)	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Punonjes per punime ne rruge dhe asfaltim	5 (pese)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	10 (dhjete)	Leje Drejtimi
- Manovrator	10 (dhjete)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Shkurt 2024 - Prill 2024.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”

date 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome Universitare, Diplome e shkolles mesme/Leje Drejtimi /Certifikate e Aftesise Profesionale etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shtetërore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Po ashtu profilet e kërkuar dhe numri i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion, pasi parashikohen punime te natyres per germimin e dheut, Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, Transport dheu me auto deri 5.0 km, Shtrese cakulli 20 cm, makadam, përhapur e ngjeshur makineri, Shtrese stabilizant t=10cm, Shtrese stabilizant t=8 cm (bankinat), Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri, Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri.

Sa me siper me qellim realizimin e punimeve ne perputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukse te kontrates si dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithe etapat e punes qe kerkohe te realizohet, kerkon mimimalisht stafin e kerkuar.

2.3.6 Operoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:

2.3.6/a -1 (nje) Inxhinier i pajisur me Certifikate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Shkurt 2024 - Prill 2024

2.3.6/b -1 (nje) Inxhinier te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Shkurt 2024 - Prill 2024.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Natyrë e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatës lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rreziq dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatës të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12 -18 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	4
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 2 – 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	4
4	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
5	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
6	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
7	Fadrome me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
8	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
9	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Rimorkjator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
12	Autobot uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
13	Rrul Vibruës Gome – Hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2

14	Rrul Vibruet Hekur – Hekur me peshe jo me te vogel se 12 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
15	Prerese asfalti	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
16	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojë një kujdes maksimal në transportin e mbetjeve inerte me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si me poshte vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- c. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti

Për impiantin e prodhimit të inerteve/asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit, është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit.

(KVO do të verifikojë nëpërmjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është i pajisur me license 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar në zerat e preventivit si dhe punimeve që do të realizohen dhe rendesise se vecante të këtyre materialeve duke qenë se përbejnë pjesën më të konsiderueshme të preventivit të punimeve.

Autoriteti Kontraktues referuar zerave objekt i kontratës që po prokurohet ka kërkuar që impiantet e prodhimit të cilat mund të jenë në pronësi, me qera ose marrëveshje bashkëpunimi të operatorit ekonomik që do të shpallet fitues si një garanci teknike që kontrata do të realizohet brenda afateve dhe në të gjithë kompleksitetin e zerave të punimeve

Autoriteti Kontraktor nuk kërkon asnjë dokumentacion nga subjekte të treta pasi verifikimi nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është i pajisur me license 3.1.B sipas kërkesave ligjore për mbrojtjen e mjedisit, do të bëhet nëpërmjet QKB-se.

2.3.10 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj

- **ISO 45001 : 2018**, mbi “Per Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurise në Punë”,
- **ISO 14001:2015**, mbi “Per Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalentin e e saj .
- **ISO 39001:2012** , mbi “Per Sistemin e Menaxhimit të Sigurise ne Trafikun Rrugor” ose ekuivalentin e saj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurimet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe Menaxhimit të Sigurise ne Trafikun Rrugor janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: